

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U kallëzua në SPAK, ministri i Financave publikon pagat: Ja sa kushton kërkesa e gjyqtarëve – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/u-kallezua-ne-spak-ministri-i-financave-publikon-pagat-ja-sa-kushton-kerkesa-e-gjyqtareve/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 16:47:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 16:46:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	39db888a1a3522bf3c21319397a9f91aec60b0f80fbd69bfc95c84b099eacd72
TEKSTI	10d77202e1859acd8fd95043902041c837f77453078356dc3e02cce86793e6ee
PAMJA	853126d43fe914a1c54ca21835d8d8bdec0c49f157255323199c15e73b73f029

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04f72b6b63acb9ceb5170ba3089eda8141c90d45c1bb29e778886adbb8798e5d
E MËPARSHMJA	3dfe60884c40e161e2881048523adccd121950db674b009c662fa81a01c343b6
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04f72b6b63acb9ceb5170ba3089eda8141c90d45c1bb29e778886adbb8798e5d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Ministri i Financave, Petrit Malaj, ka reaguar pas kallëzimit penal të depozituar ndaj tij, Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorëve të Thesarit në të gjithë vendin, lidhur me refuzimin për të ekzekutuar pagesa shtesë për gjyqtarët dhe prokurorët.

Malaj deklaroi se institucioni që ai drejton ka vepruar në përputhje me ligjin dhe se ndryshimi i pagave do të mund të zbatohet pas miratimit të ligjit në Parlament më 17 shtator.

Në reagimin e tij, në rrjetet sociale ministri ka bërë publike edhe faturën financiare të kërkesave të magjistratëve, duke thënë se ato do t'i kushtonin buxhetit të shtetit rreth 40 milionë euro shtesë çdo vit, ndërsa për periudhën 2023-2026 efekti do të arrinte në 125 milionë euro.

POSTIMI I MALAJT:

Të kallëzohesh sepse po zbaton ligjin, nga garantët e barazisë para ligjit! Sot, në Ministrinë e Financave u depozitua një kallëzim penal për mua si titullar i institucionit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e thesarit në të gjithë Shqipërinë.

Arsyeja: Kemi refuzuar të hapim dyert e thesarit të shtetit për të nxjerrë që aty pa vendim të parlamentit një volum të konsiderueshëm parash, si shtesë rroge për gjyqtarët dhe prokurorët.

Nuk dua të bëj asnjë polemikë me askënd dhe as të risqaroj pozicionin e Ministrisë së Financave, ndërkohë që është thënë publikisht nga qeveria shqiptare dhe përfaqësuesit e Parlamentit, se askush nuk do të pengojë adresimin e çështjes së pagave sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të ndodhë më 17 shtator, kur të miratohet ligji që i jep Ministrisë së

5 Zjarri masiv në Kroaci, evakuohen 230 persona, flakët afrohen pranë...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Financave të drejtën administrative të veprimit.

Por, kjo nuk i ka penguar përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor që të përshkallëzojnë konfliktin me ekzekutivin duke nënshkruar një kallëzim penal që do ta marrë me siguri historia.

Ndërkohë unë sot dua t'u bëj me dije qytetarëve sa kushton kërkesa e kallzuesve të nderuar, sipas shkallës së pagave:

Gjyqtar i Shkallës së Parë

Është: 376, 381 Lekë

Kërkohet: 567,421 Lekë

Gjyqtar i Shkallës së Dytë

Është: 388,927 Lekë

Kërkohet: 586,335 Lekë

Gjyqtar i Grupit të III në GJKKO

Është: 659,920 Lekë

Kërkohet: 994,877 Lekë

Efekti total në buxhetin e shtetit me këto kërkesa është 40 milionë euro shtesë, çdo vit. Por nuk mbyllet këtu.

Magjistratët kërkojnë rishikim të pagave për periudhën 2023-2026 me një efekt në buxhetin e shtetit 125 milionë euro.

Ndërkohë u them drejtores të Thesarit në të gjithë Shqipërinë dhe Sekretarit të Përgjithshëm, që sot u kallëzuan së bashku me mua, se duhet të vazhdojnë ta kryejnë detyrën e tyre me qetësi dhe pa u intimiduar, duke ruajtur gjithmonë me rigorozitet financat e shtetit, të udhëhequr nga ligji.

/vizionplus.tv

#Gjyqtar

#MALaj

#paga

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh




EKONOMI

Kërkohet më shumë kredi për shtëpi,...

Xhuljana Zhuleku


Dje
17:01



EKONOMI

Nisma e qeverisë për strehimin social,...

Taulant Halili · 11 Sht



EKONOMI

Financimi i Grave Sipërmarrëse,...

Taulant Halili · 8 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale